

JETA SHKENCORE**“VARIACIONI SINTAKSOR NË TË FOLMET E SHQIPES: TIPARE DHE TREVA”, TRYEZË E RRUMBULLAKËT, 13 DHJETOR 2017**

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë organizoi tryezën e rrumbullakët “Variacioni sintaksor në të folmet e shqipes: tipare dhe treva”. Kjo tryezë shkencore u mbajt si një hap vijues mbas konferencës së vitit të kaluar “Variacioni sintaksor në të folmet dhe dialektet e shqipes” në rrugën drejt përgatitjes për projektin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes. Tryeza i zhvilloi punimet në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave më 13 dhjetor 2017, nga ora 10 deri në ora 16. Kjo tryezë ishte konceptuar në formën e kumtesave dhe diskutimeve të përgatitura për tiparet, trevat dhe metodat e hulumtimit për hartimin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes.

Tryeza u hap me kumtesën “Metodat e hulumtimit për rastin e shqipes” nga Enkelejda Kapia, Akademia e Studimeve Albanologjike. Autorja u përqendrua në çështje të metodologjisë shkencore për mbledhjen e të dhënave gjuhësore dhe hartimin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes. Autorja propozoi edhe disa metoda të reja që mund të përdorëshin për këtë qëllim, duke shprehur mendimin se në varësi të tiparit sintaksor të hetuar, do të përzgjidhej edhe metoda e hulumtimit.

Marjo van Koppen, Universiteti i Utrehtit, mbajti referatin “Methodological considerations in the Syntax Dialect Project in Netherlands”. Në referatin e saj profesoresha trajtoi punën kërkimore që u krye për hartimin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore në Holandë. Autorja foli në mënyrë konkrete për metodat e reja të zbatuara, literaturën shkencore dhe hapat që u ndoqën nga fillimi deri në përfundimin me sukses të këtij projekti. Ndihmues ishte diskutimi i saj në lidhje me përparësitë dhe vështirësitë që dalin gjatë zbatimit të secilës prej metodave. Ajo u shpreh e gatshme të jepte ndihmën e saj për hartimin e një atlasi të tillë edhe për gjuhën shqipe. Së fundi, në rolin e zëvendës drejtueses së projektit Edisyn për sintaksën e dialekteve evropiane, profesoresha shprehu dëshirën dhe ftesën që gjuha shqipe të përfaqësohej në rrjetin e sintaksës së dialekteve evropiane.

Maria S. Morozova, Alexander Yu. Rusakov, Andrey S. Sobolev, Universiteti i Shën Peterburgut, mbajtën kumtesën “Reccomendations regarding the future ‘Atlas of Albanian Dialect Syntax’”. Autorët folën për rrjetin e pikave përfaqësuese të Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes dhe kishin përgatitur disa rekomandime për

pikat referuese, për metodologjinë, për natyrën dhe numrin e informantëve që nevojiteshin për një punë të tillë, si dhe sugjeruan një sërë tiparesh sintaksore që mund të hulumtoheshin për qëllimet e Atlasit. Ata u shprehën të gatshëm që institucioni i tyre në Rusi të bashkëpunonte për këtë projekt me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Elvira Glaser, Universiteti i Zrihut, do të vijonte me kumtesën “Përvoja e Atlasit sintaksor të të folmeve të gjermanishte të Zvicrës”, por nuk u arrit të realizohej lidhja me Skype. Profesoresha do ta mbajë fjalën e saj në një seminar të afërt në janar 2018 që do të organizojë Institutin i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Punimet e tryezës vazhduan me kumtesën “Mendime për tiparet sintaksore” nga Seit Mansaku. Profesori vlerësoi rëndësinë e një Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipërisë si një vepër me peshë. Ai bëri disa sugjerime për pikat e Atlasit dhe diskutoi konkretisht për tiparet sintaksore dialektore që mund të përfshihen në të, duke ofruar edhe disa mendime shkencore ndihmuese në këtë drejtim.

Mehmet Çeliku mbajti kumtesën “Mendime rreth krijimit të një korpusi të materialit sintaksor dialektor të shqipërisë: tipare të përbashkëta dhe variacione”. Profesori trajtoi çështje të dallimit dhe përndarjes së tipareve sintaksore. Ai bëri sugjerime konkrete duke iu referuar përvojës së vet shumëvjeçare si dialektolog. Më tej ai foli për kriteret shkencore që lypet të zbatohen në përzgjedhjen e informantëve, metodologjinë e punës,

pikat e referimit të Atlasit, fazat konkrete dhe baza materiale dhe njerëzore që nevojiten për realizimin e një projekti të tillë. Profesori e vlerësoi projektin si një vepër madhore me vlerë historike për ruajtjen e gjuhës si pasuri kombëtare, dhe si e tillë, ajo duhet të kishte të gjithë mbështetjen e nevojshme të institucioneve përkatëse dhe të qeverisë shqiptare.

Anila Çepani & Adelina Çerpja, Universiteti i Tiranës & Akademia e Studimeve Albanologjike, mbajtën kumtesën “E folmja e diasporës së moçme shqiptare në Greqi: tipare sintaksore dhe treva”. Autorët folën për rëndësinë dhe mundësitë e përfaqësimit të arbërishtes së diasporës shqiptare në Greqi. Vëmendje iu kushtua nxjerrjes në pah të disa tipareve sintaksore të veçanta të kësaj të folmeje.

Kumtesa “Mendime për tiparet sintaksore” e profesor Remzi Përnaskës u lexua nga Tomor Plangarica, Akademia e Studimeve Albanologjike. Profesor Përnaska ofroi mendime me vlerë për rëndësinë e përzgjedhjes së kujdesshme të informantëve, duke vijuar me analizën dhe sugjerimet për disa tipare sintaksore me tipar dialektor që nevojitet të hulumtohen për nevojat e Atlasit.

Asllan Hamiti, Ajten Hajdari, Ismet Osmani, Berton Sulejmani & Izmit Durmishi, Universiteti i Shkupit & Universiteti i Tetovës, mbajtën kumtesën “Mendime për trevat dialektore shqipfolëse në Maqedoni”. Autorët e vlerësuan rëndësinë e Atlasit Dialektor të Sintaksës së Shqipërisë si një hap i rëndësishëm në gjeografinë gjuhësore të shqipërisë dhe rolin e madh të tij në ruajtjen e pasurisë së gjuhës shqipe. Në vijim, nëpërmjet një studimi

të plotë dhe të detajuar, ata dhanë pikëpamjet e tyre rreth pikave dialektore që duhet të përfaqësojnë shqipen e folur në Maqedoni në Atlas. Në fund, studiuesit ofruan bashkëpunimin e institucionit të tyre.

Mimoza Karagjozi, Universiteti i Tiranës, mbajti kumtesën “Disa tipare sintaksore të së folmes së Gjirokastrës dhe mendime mbi vendin e së folmes së Gjirokastrës në trevat e toskërishtes jugore”. Autorja, pasi bëri një analizë të disa tipareve sintaksore dialektore të të folmes së Gjirokastrës, shprehu mendimin se kjo e folme ka më shumë ngjashmëri me çamërishten sesa me labërishten. Ajo sugjeroi një mënyrë më të saktë të përfaqësimit të kësaj të folmeje në Atlas.

Tomor Plangarica, Akademia e Studimeve Albanologjike, mbajti kumtesën “Mbi disa tipare morfo-sintaksore të pranishme edhe në të folmen e Elbasanit dhe disa aspekte të metodologjisë në vjelje e shqyrtim”. Autori e vuri theksin në qasjen ndërdisiplinore ndaj një projekti në lidhje me variacionin sintaksor në të folmet e shqipes, duke e parë Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes në një qasje më të gjerë, si pjesë e një projekti më të madh, i cili synon mbledhjen e pasurisë gjuhësore të shqipes, me qëllim që të shërbejë për studime në fusha të ndryshme të shkencës, dhe jo ngushtësisht për Atlasin. Profesori ofroi një sërë mendimesh me vlerë për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e një qasjeje të tillë. Në vijim, ai foli për disa aspekte të metodologjisë në vjelje e shqyrtim.

Gjovalin Shkurtaç mbajti kumtesën “Mendime për trevat e gegërishtes veriperëndimore”. Si dialektolog me

përvojë të gjatë në këtë fushë kërkimore dhe bashkautor i Atlasit Dialektologjik të Shqipes (2007, 2008), akademiku dhe profesori Shkurtaç ofroi përvojën e tij dhe dha mendime e orientime me vlerë në lidhje me informantët, metodologjinë, disa tipare sintaksore të të folmeve të malësorëve të Mbishkodrës si dhe për trevat e gegërishtes perëndimore që duhen të pasqyrohen në Atlasin e Sintaksës Dialektore të Shqipes.

Rami Memushaj diskutoi rreth metodologjisë kërkimore më të përshtatshme për përgatitjen e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes dhe trevat e tij, veçanërisht në zonën e Labërisë. Si profesor me përvojë të gjatë në studimet fonetiko-gramatikore të shqipes dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Institutit të Gjuhësisë, ai ofroi ndihmën dhe bashkëpunimin e tij për këtë projekt.

“Puna për hartimin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes: arritje dhe probleme” ishte në fokus të diskutimit të Anila Kananaj, Akademia e Studimeve Albanologjike. Autorja bëri një parashtrim të punës së bërë në vitin 2017 nga punonjësit shkencorë të Institutit të Gjuhësisë për identifikimin, përgjithësimin dhe kategorizimin e tipareve sintaksore dialektore në trevat e Shqipërisë. Kjo punë u finalizua me një listë prej afërsisht 60 tiparësh sintaksore, të ilustruara me shembuj konkretë të përdorimit të tyre në trevat përkatëse, e cila iu dërgua paraprakisht studiuesve dhe pjesëmarrësve të interesuar nga organizatorët e tryezës, prof. dr. Anila Omari, prof. as. dr. Enkelejda Kapia & prof. as. dr. Adelina Çerpja. Në vijim, Kananaj diskutoi rreth disa problemeve me karakter

teorik dhe disa vështirësi specifike për shqipen, që janë ndeshur në punën kërkimore në fushë të sintaksës dhe ka gjasë të ndeshen gjatë realizimit të Atlasit.

Merita Bruci, Akademia e Studimeve Albanologjike, diskutoi rreth rëndësisë së një projekti për mbledhjen e pasurisë dialektore të shqipes, duke shprehur dëshirën që projektit t'i jepej një frymëmarrje më e gjerë dhe qasje ndërdisiplinore. Studiuesja ndau përvojën e saj në lidhje për kërkimet dialektore për shqipen e arbëreshëve të Italisë dhe vuri në dukje disa mundësi dhe rrugë konkrete të vijimit të punës për realizimin e një Atlasi të Sintaksës Dialektore të Shqipes.

Artan Xhaferaj, Universiteti i Vlorës, kishte për gatitur një diskutim në lidhje me tiparet e Atlasit të Sintaksës Dialektore të shqipes. Autori foli konkretisht për disa tipare

sintaksore që kishte vënë re në të folmen e Vlorës, të cilat mund të merreshin parasysht për Atlasin.

Rafaela Marteta, Akademia e Studimeve Albanologjike, ofroi diskutime dhe reflektime me vlerë për përgatitjen e Atlasit të Sintaksës Dialektore të Shqipes, duke vënë në pah përdorimin e metodave bashkëkohore që ofrojnë qasjen e duhur teorike dhe praktike për një punë të tillë.

Tryeza shkencore zgjoi interes të gjerë, çka u tregua në pjesëmarrjen dhe diskutimet e gjalla që e shoqëruan aktivitetin.

Punimet e tryezës i mbylli drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, prof. dr. Valter Memisha, i cili vlerësoi edhe një herë rëndësinë e aktivitetit dhe përgëzoi të pranishmit për kontributin e tyre me kumtesa ose dhe diskutime.

ANILA KANANAJ